



REPUBLIKA E SHQIPËRIË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

VENDIM

Nr. 194 Prot

Shkodër me 15.04 2024

Nr. 5, Datë 09.04.2024

“Mbi disa ndryshime në VKQ nr. 21, datë 28.12.2023 ”Mbi miratimin e në Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024 dhe PBA Përfundimtar 2024-2026 ”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 09.04.2024, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Mbi disa ndryshime në VKQ nr. 21, datë 28.12.2023” Mbi miratimin e në Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024 dhe PBA Përfundimtar 2024-2026”, bazuar nën 38 e 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.97/2023 “Per Buxhetin e Vitit 2023”, pikat 3 e 4 të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKQShkoder nr.21, datë 28.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024 dhe PBA Përfundimtar 2024-2026”, pika 2 e VKQ Shkoder nr.18, datë 28.12.2023 “Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2024 për Këshillin e Qarkut Shkodër”, VKB nr.55, datë 29.12.2023 të Bashkisë Shkodër, VKB nr.6, datë 18.01.2024 të Bashkisë Malësi e Madhe, VKB nr.91, datë 21.12.2023 të Bashkisë Vau Dejës, VKB nr.35, datë 29.12.2023 të Bashkisë Fushë Arrëz si dhe VKB nr.08, datë 18.03.2024 të Bashkisë Pukë, Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me 17 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në pikën 1/c të buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024, pas miratimit të Kuotës së antarësisë, që Bashkitë e Qarkut Shkodër i financojnë Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024, shtesë në planin e të ardhurave në shumën 1,940,000 lekë.

- a. Kuota e Antarësisë, që bashkitë kanë planifikuar të financojnë Qarkun Shkodër për vitin 2024 do të jetë si më poshtë;



➤	Bashkia Shkodër	shuma	1,000,000 lekë
➤	Bashkia Vau Dejës	shuma	600,000 lekë
➤	Bashkia Malësi e Madhe	shuma	200,000 lekë
➤	Bashkia Fushë Arrëz	shuma	100,000 leke
➤	Bashkia Pukë	shuma	40,000 leke
	Totali		1,940,000 leke

- b. Shuma 1,000,000 lekë të përdoret për financimin e projektit “Projektim I Projektit të Rrugës Bardhaj Rrenc” dhe pjesa tjetër në shumën 940,000 lekë të përdoret për bashkëfinancim projektesh me Financim të Huaj, përkatësisht;

SHTOHET

Progr. 04520 Art. 230 “Projekt për investimin-Asfaltim rruga Bardhaj-Qafë Rrenc” në shumë 1,000,000 lekë

Progr. 04130 Art 604 “Bashkëfinancim me Projektet e BE-së” në shumë 940,000 lekë

2. Të miratohet ndryshimi i pikës 3 të VKQ nr.21, datë 28.12.2023. Kjo pikë bëhet - Investimi ”Rikonstruksion i rrugës Trush i Poshtëm, Bashkia Vau Dejës“, do të jetë bashkëfinancim me Bashkinë Vau Dejës dhe shuma e planifikuar në buxhetin e vitit 2024 prej 30,500,000 lekësh, të transferohet nga Këshilli I Qarkut Shkodër në Bashkinë Vau Dejës për këtë investim në vitin 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

